



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 060/01-2480/20
Kaçanik, 31.01.2020

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **I-r (Parë)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2020 (Legjislatura e VI-të), mbajtur me 31 Janar 2020. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve të KK, pjesëmarrës në mbledhje ishin 27 anëtarë-të gjithë.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, të gjithë drejtorët e drejtorive komunale (7), ndërkaq nga zyrtarët e komunës: Hidajete Guri dhe Ilirijana Berisha.

Në mbledhje mori pjesë, Kryesues i Komitetit Konsultativ të PAK, Artan Mezraja.

Nga OSBE, mbledhjen e monitoroj, Faruk Dërmaku.

Nga strukturat vendore, mbledhja u monitorua përmes, Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës, Makfirë Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, në vazhdim konstatoj kuorumin duke i thirrur emër për emër të gjithë anëtarët e KK, pjesëmarrës në mbledhje janë 27 anëtarë, kuorumi ekziston, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e 1 (Parë) të Rregullt për vitin 2020, data 31 Janar, prezantoj rendin e punës si në ftesën për mbledhje duke propozuar të hynë në rend pune edhe pika: Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 60/01-36810/19 të datës 29.11.2019- për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. Nëse ka kush diçka në rendin e punës, e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Në emër të GP LVV konfirmoj se jemi më shtyrë për mbledhjen vijuese pikën e propozuar nga Kryesuesi i Kuvendit, Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 60/01-36810/19 të datës 29.11.2019- për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për shkak së kjo pikë nuk ka qenë në rend pune në ftesën për mbledhje dhe materiali për këtë pikë na është shpërndarë në mbledhje. Pos kësaj, kërkoj që pika: Raport (Informatë) i punës së Njësisë së Personelit për periudhën: Janar-Dhjetor 2019; të shtyhet për mbledhjen vijuese, për shkak së nuk e kemi marrë materialin për këtë pikë.

z. Nexhat Loku, Në emër të GP të PDK, konfirmoj së jemi të pajtimit që në këtë mbledhje të shqyrtohet pika të cilën e propozoj Kryesuesi i Kuvendit, Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 60/01-36810/19 të datës 29.11.2019- për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të shqyrtohet në këtë mbledhje, pasi që këtu ka më u bërë vetëm ndryshimi i një anëtari të komisionit.

z. Selim Reka, Në emër të GP të LDK, konfirmoj se jemi me shtyrë për mbledhjen vijuese pikën e cila u propozuar nga Kryesuesi i Kuvendit; Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 60/01-36810/19 të datës 29.11.2019- për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të shqyrtohet në këtë mbledhje, pasi që këtu ka më u bërë vetëm ndryshimi i një anëtari të komisionit.

znj. Lirije Luta, Unë kërkoj që pika: Plani strategjik i veprimit të Grupit të Grave për vitin 2020; të hiqet nga rendi i punës, për shkak së kam më ripërpunuar ende këtë plan pune.

Kryesuesi i Kuvendit, Atëherë Rendin e propozuar të punës e shtroj në votim për aprovim me heqjen e pikave: Raport (Informatë) i punës së Njesisë së Personelit për periudhën: Janar-Dhjetor 2019; Plani strategjik i veprimit të Grupit të Grave për vitin 2020; dhe pikën e propozuar në mbledhje, Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 60/01-36810/19 të datës 29.11.2019- për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës do të punoj me këtë:

REND PUNE

1. Betimi solemn i anëtarit të Kuvendit të Komunës nga LVV, Agim Mani;
2. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e dymbëdhjetë (12) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, i datës 27 Dhjetor 2019;
3. Plani i punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2020;
4. Plani vjetor i punës së Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi, për vitin 2020;
5. Raport (Informatë) i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019;
6. Draft Rregullorja për ndryshim plotësimin e Rregullores 01/2018 (01Nr. 02-/01-11899) për bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane të Komunës së Kaçanikut (leximi i dytë);
7. Propozim Vendimi për rishqyrtimin e vendimit të KK 01Nr. 104/02-36179/19 i datës 29.11.2019 - për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e komunës së Kaçanikut;
8. Propozim Vendimi për miratimin e Nismës së Kryetarit të Komunës së Kaçanikut, për bashkëpunim ndër-komunal me Komunën e Shtërpçës në fushën e infrastrukturës rrugore në viset rurale;
9. Plani i punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2020;
10. Raporti i punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2019;
11. Informatë e DAK për përfundimin e Periudhës së Parë të Vitit shkollor 2019-2020;
12. Informatë për aktivitetin e Kuvendit të Komunës për vitin 2019.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Betimi Solemn i anëtarit të Kuvendit të Komunës nga LVV, Agim Mani;

Kryesuesi i Kuvendit, E ftoj anëtarin e Kuvendit të Komunës, Agim Mani të ngritët në këmbë dhe para anëtarëve të KK të jep Betimin për Anëtar të Kuvendit të Komunës, ndërkaq në shenjë respekti për anëtarin e zgjedhur të KK, kërkoj të ngritën në këmbë të gjithë të pranishmit që janë në këtë mbledhje.

z. Agim Mani- Anëtar i zgjedhur nga LVV, fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit, e lexoj tekstin e Betimin Solemn si në nenin 35.5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si vijon: “Beto hem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”. Deklarata e betimit u nënshkrua nga Agim Mani.

Kryesuesi i Kuvendit, Falënderoj anëtarin e Kuvendit të Komunës, Agim Mani për betimin e dhënë, i dëshiroj punë të mbarë në aktivitetin e KK, ndërkaq konstatoj;

Ndryshim plotësimit e përbërjes së Kuvendit të Komunës të Legjislaturës së gjashtë (6) të KK të zgjedhur me 22 Tetor 2017 / Lënda: 01Nr. 60/02-1676/20.

Në bazë të Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr. 38/202 të datës 15.01.2020- pranuar më datë 16.01.2020, anëtari i dorëhequr nga LVV, Shpend Krusha, KQZ, zëvendësohet me kandidatin e radhës nga subjekti politik i LVV, Agim Mani.

Anëtari i Kuvendit të Komunës, Agim Mani, nga data e betimit dhe nënshkrimit të deklaratës solemne, i realizon të gjitha të drejtat dhe detyrat si anëtarët tjerë të Kuvendit të Komunës, përfshirë edhe kompensimin (paushallin dhe kompensimin për pjesëmarrje në mbledhje). Anëtari i lartcekur i KK, nga kjo datë i merr të gjitha përgjegjësitë të cilat i takojnë si anëtarët tjerë të KK., ndërkaq pushon të jetë anëtar sipas dispozitave të nenit 37.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040.

2. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, nëse ka kush ndonjë vërejtje lë të urdhëroj:

z. Adnan Reka, Të Pika 9. Propozim Vendimi për përmirësimin e gabimit teknik të Vendimit të KK 01Nr. 941/01-34155/2019 të datës 31.10.2019 për këmbimin e pronës komunale me pronën private në emër të Razim Palloshi nga f. Biçec. Anëtarët e LVV kemi abstenuar, ndërkaq votat e këtij subjekti politik janë shënuar Kundër.

Kryesuesi i Kuvendit, Atëherë me këtë gabim teknik, e shtroj në votim Procesverbalin e mbledhjes së 12 të rregullt të Kuvendit të Komunës. Rezultati i votimit, njëzëri Për. Anëtari Agim Mani mundet të abstenoj nëse dëshiron, sepse nuk ka qenë pjesë e procesit. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

APROVOJ

Procesverbalin nga mbledhja e XII-të (Dymbëdhjetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2019 të datës 27 Dhjetor 2019 / Lënda: 01Nr. 60/01-39809/19.

Procesverbali do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës i korrigjuar.

Kryesuesi i Kuvendit, Para se me kaluar në pikët tjera të rendit të punës, nëse ka kush ndonjë pyetje apo kërkesë, lë të urdhëroj:

Pyetjet dhe Kërkesat

z. Ekrem Kyçyku, Unë i shprehi shqetësimet e mia edhe një herë për gjendjen e shkatërrimit të pyjeve në Komunën e Kaçanikut, me theks të veçantë, prerjen e pyjeve në Malet e Sharrit –përfshirë edhe prerjen e pishave në atë pjesë.

z. Adnan Reka, Kërkojmë nga DSHPE, të bëjë sanimin e gropës së mbushur me ujë që përfshinë më tepër se gjysmën e rrugës, në segmentin e rrugës Bob – Kovaçec , me saktë përballë shkollës së mesme profesionale.

z. Bekim Koxha, Unë nga kjo mbledhje ju njoftoj së kalojë anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa në vend të anëtares nga po i njëjti subjekt politik NISMA, Hafize Sallahi, ndërkaq Hafizja bëhet shefe e GP të subjektit politik NISMA. Unë shqetësimet e mia të cilat i kam dhe të njëjtat mundem t'i shpërndaj tani.

Kryesuesi i Kuvendit, Sa i përket zëvendësimit të anëtarit në KPF, së pari duhet anëtarja e KPF Hafize Sallahi më ofruar dorëheqje nga pozita e anëtarit në KPF, pastaj me u bërë zëvendësimi i saj. Ju si subjekt politik për shef të GP mundeni vet të merrni vesh për këtë çështje. Ndërkaq, sa i përket shqetësimeve tua që i ke, mundësh me ua dhënë shefave të GP të përfaqësuara në KK.

z. Shemsedin Luzha, Fillimisht e përshëndes anëtarin e ri të zgjedhur të KK, Agim Mani, i dëshiroj suksese në aktivitetin e punës së KK.

Unë i në kam shtatë (7) pyetje për ekzekutivin e komunës:

1. Rruga në f. Bëgracë në lagjen Luzha, është dëmtuar shumë shpejt nga koha kur është ndërtuar. Këtë e themi, sepse kësaj rruge iu ka hequr një shtresë asfalti dhe e njëjta është dëmtuar 1 m në 8 km në 177m. rrugë ;
2. Më intereson të di, A është marrë ndonjë veprim lidhur me kërkesën të cilën e kam ngritur për një vend pune në arsim që paguhen dy arsimtarë;
3. Në f. Bëgracë nuk ka fushë futbollit nga viti 2003, këtu është mirë të bëhet diçka në këtë drejtim për ndërtimin e një fushe futbollit;
4. Ura në Kaçanik të Vjetër nuk është ndërtuar mirë, ndërkaq dihet sesa është e frekuentuar ajo pjesë;
5. Zyra e Vendit në Kaçanik të Vjetër ka kohë që nuk funksionon, me intereson të di, ku janë arsyet?
6. Shprehi shqetësimet e mia për, mungesën e ndriçimit publik në fshatin Doganaj, pjesa për gjatë lokaleve afariste;
7. Kam vërejtje që qytetarët e komunës, i prenë rrugët e asfaltuara për nevoja të tyre pa marrë ndonjë leje nga komuna.

z. Selim Reka, Fillimisht e uroj anëtarin e zgjedhur të KK Agim Mani, i uroj shëndet dhe suksese në aktivitetin e KK. Kërkoj nga organet përgjegjëse të komunës t 'na ofrojnë një Informatë me shkrim për një shumë të mjeteve buxhetore të cilën e ka paguar komuna për një pronë në afërsi të banesës së madhe në Kaçanik.

Kryesuesi i Kuvendit, Pyetje e Kërkesa të tjera nuk ka, besoj së përgjigjet do t'i merrni nga ekzekutivi i komunës, ndërkaq konstatoj me vazhduar me pikët tjera të rendit të punës sipas radhës:

3. Plani i punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, kjo çështje është shqyrtuar edhe në KPF dhe e njëjta i ka kaluar KK në procedurë për shqyrtim. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Në Planin e punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2020, shihet së janë përshkruar punët dhe detyrat e punës që kanë sektorët, ndërkaq shumë pak ka punë të planifikuara. Plani është indentik më atë të vitit 2019, vetëm se iu ka ndërruar rënditja drejtorive. Të DSHMS, të objektiva, në kuadër të objektivës me Nr. 1 është paraqitur objektivë: Disiplina në punë nga drejtori e deri të portiri. Kjo nuk është objektivë, disiplina në punë është detyrë e secilit të punësuar. Për mendimin tim, ky plan pune nuk jep shumë shpresë për realizimin e nevojave të qytetarëve të komunës tonë. Në planin e vitit 2019 ka qenë objektivë, Zbatimi i ligjit kundër pirjes së duhanit, mirëpo kjo objektivë nuk është realizuar, kur dihet se duhani po konsumohet pothuajse kudo në lokale të Komunës së Kaçanikut.

z. Selim Reka, Ne subjekti politik i LDK kërkojmë që ky plan të zbatohet, ndërkaq të kihet parasysh çështja e projekteve me prioritet, mënyra sesi tenderohen dhe forma e menaxhimit të projekteve.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, Plani i punës së Ekzekutivit të Komunës nuk del në votim, kështu që konstatoj se Kuvendi i Komunës u,

Njoftua

Me Planin e Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2020 / Lënda: 01Nr. 60/01-2133/20.

3. Plani vjetor i punës së Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi, për vitin 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, Ky këshill i ka të përcaktuara me Udhëzim Administrativ me i mbajtur gjithsej 6 mbledhje me kompensim për gjatë një viti. Në këtë plan janë paraqitur objektivat e këtij këshilli në secilën mbledhje, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Meqë nuk ka kush për diskutim, atëherë këtë Plan pune e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë nuk pati, Abstenoj, Ekrem Raka. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë ,

VENDIM

Për Aprovimin e Planit vjetor i punës së Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi, për vitin 2020 / Lënda: 01Nr. 060/01-1918/20.

5. Raport (Informatë) i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, për sqarime të nevojshme nëse ka, prezent në mbledhje është Kryetari i Komunës Besim Ilazi- njëherë eshtë Kryesues i KKS. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës u,

Njoftua

Me Raportin (Informatë) e punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019, u njoftua me aktivitetin e KKSBB për vitin 2019 / Lënda: 01Nr. 104/02-1342/20.

6. Draft Rregullorja për ndryshim plotësimin e Rregullores 01/2018 (01Nr. 02-/01-11899) për bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane të Komunës së Kaçanikut (leximi i dytë);

Kryesuesi i Kuvendit, Rregullorja e ka kaluar procedurën e debatit publik me qytetarë të komunës dhe e njëjta është proceduar në KK është në lexim të dytë. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Adnan Reka, Duke pasur parasysh se ne nuk i dimë kriteret që janë aplikuar për ndryshim-plotësimin e kësaj Rregullore, dhe faktet që Rregullorja aktuale në fuqi është shkelur disa herë, pikërisht nga propozuesit e kësaj Rregullore, ne do të votojmë kundër.

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë Draft Rregulloren e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin 5 anëtarët nga LVV: Adnan Reka, Agim Mani, Ekrem Kyçyku, Fatijona Kyçyku dhe Kaltrina Tafili, ndërkaq Abstenuan 3 anëtarë: Afërdita Shehi, Shemsedin Luzha dhe Ekrem Raka. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

APROVOJ

Rregullore për ndryshim plotësimin e Rregullores 01/2018 (01Nr. 02-/01-11899) për bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane të Komunës së Kaçanikut / Lënda: 01Nr. 60/01-36408/19.

7. Propozim Vendimi për rishqyrtimin e vendimit të KK 01Nr. 104/02-36179/19 i datës 29.11.2019 - për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e komunës së Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit, MMPH Vendimin për Emërtimin e rrugëve lokale e ka kthyer në rishqyrtim më i bërë disa ndryshime. Drejtori i DAP, Festim Neziraj shkresës së Ministrisë iu ka kundërpërgjigjur me një shkresë së disa nga vërejtjet e dhëna nga kjo ministri nuk janë në rregull. Ministria përkatëse është pajtuar me kërkesën e DAP, ndërkaq ka identifikuar vetëm dy emra të rrugëve që duhet të ndryshohen. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin. Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e komunës së Kaçanikut / Lënda: 01Nr. 104/02-1699/20.

Me marrjen e këtij vendimi, Shfuqizohet, Vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 104/02-36179/19 i datës 29.11.2019 - për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e komunës së Kaçanikut.

8. Propozim Vendimi për miratimin e Nismës së Kryetarit të Komunës së Kaçanikut, për bashkëpunim ndër-komunal me Komunën e Shtërpçës në fushën e infrastrukturës rrugore në viset rurale;

Kryesuesi i Kuvendit, Theksoj se kjo Nismë krijon mundësinë me aplikuar për fonde në MAPL për projekte ndër komunale. Fondi i paraparë është diku 150,000.00€ mirëpo

paraprakisht duhet të lidhet, Marrëveshja me Komunën e Shtërpçës. Komuna jonë në bashkëpunim me Komunën e Shtërpçës janë pajtuar me i nisur negociatat për zgjerimin dhe rregullimin e rrugëve që lidhin këto dy komuna, fshati Sllatinë dhe fshatin Brod, që mundësojnë lëvizje me të mirë të qytetarëve dhe zhvillimin e turizmit. Për këtë pikë, fjalën e ka Kryetari i Komunës, Besim Ilazi.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Ne kemi filluar me Nisma bashkëpunimi ndër komunal me Komunën e Hanit të Elezit. Tani po fillojmë me Komunën e Shtërpçës, ndërkaq nuk do të ndalemi me kaq, sepse në vazhdim mendojmë të iniciojmë nisma më komunat tjera, me Komunën e Ferizajt dhe atë të Vitisë për përfitimin e fondeve në infrastrukturë për projekte të caktuara. Kjo iniciativë është e mirëpritur, sepse na krijohen mundësitë me përfituar fonde në projekte infrastrukturore nga MAPL.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjuat sqarimet e Kryetarit të Komunës, Nëse ka kush diçka në këtë pikë e hapi diskutimin:

z. Bekim Koxha, Rruga e Vjetër për Ferizaj nga Gërlica, a ka mundësi më hyrë në marrëveshje bashkëpunimi me Komunën e Ferizajt.

Kryetari i Komunës, Me Komunën e Ferizajt ende nuk kemi iniciuar ndonjë nismë. Kur të iniciojmë iniciativa bashkëpunimi për ndonjë projekt infrastrukturorë, atëherë do të shikojmë orientimet e dy komunave se cilave projekte do t'iu japim përparësi.

Kryesuesi i Kuvendit, Për projekte duhet pasur edhe Pëlqimin e komunës tjetër. Ne mund të aplikojmë në shumë projekte, ndërkaq mund të përfitojmë fond vetëm për një projekt.

z. Selim Reka, Iniciativat e tilla janë të mira për cilindo projekt, mirëpo nuk bënë të ndalemi me kaq. Një projekt ka qenë më herët, Ndërtimi i rrugës: Kaçanik-Kërbliq-Viti. Nëse merret ndonjë iniciativë me Komunën e Vitisë, është mirë të merret parasysh ky projekt, sepse është në interes të dy komunave.

Kryetari i Komunës, Me komunën e Vitisë kemi një Memorandum bashkëpunimi, por nuk kemi Marrëveshje, ndërkaq ai projekt nuk ka mundur me u jetësuar për shkak të procedurave nga ministria.

z. Shemsedin Luzha, Unë do të votoj kundër kësaj Nisme, sepse nuk e shoh shumë të rëndësishëm realizimin e këtij projekti ndër komunal me Komunën e Shtërpçës, kur kemi projekte tjera më të rëndësishme. Edhe projektet të cilat po ndërtohen, nuk po ndërtohen si duhet, kështu që nga këto arsye do të votoj kundër.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me shumicën absolute të votave Për, Kundër votë nuk pati, Abstenoj Shemsedin Luzha. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë,

VENDIM

Për miratimin e Nismës së Kryetarit të Komunës së Kaçanikut, për Bashkëpunim Ndër-komunal me Komunën e Shtërpçës në fushën e infrastrukturës rrugore në viset rurale. / Lënda: 01Nr. 104/02-2476/20.

9. Plani i punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Në material është emërtuar Komitet Konsultativ, kjo duhet të rregullohet, sepse ky komitet nuk është konsultativ, por është komitet tjetër, ashtu që KK ka të drejtë më formuar komitete tjera sipas nevojës. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Adnan Reka, Neni 39 i Statutit të Komunës e përcakton së cilat Komitete konsultative ka të drejtë me i formuar komuna. Një nga këto komitete është, Komiteti Konsultativ për Shërbime Publike. Në vazhdim z. Reka i përmendi edhe Komitetet tjera konsultative të përcaktuara në dispozita të Statutit të Komunës që mund t'i formoj KK.

Kryesuesi i Kuvendit, Komitetet Konsultative formohen me tjetër procedurë, përfaqësohen me anëtarë nga jashtë KK. Nëse nuk ka kush diçka, atëherë me ndryshimet që të hiqet pasuesi “konsultativ”, e shtroj në votim për aprovim këtë plan pune dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin 2 anëtarë, Adnan Reka dhe Agim Mani, Abstenuan 6 anëtarët: Ekrem Kyçyku, Kaltrina Tafili, Fatijona Kyçyku, Arlinda Rakoci-Raka, Ekrem Raka dhe Afërdita Shehi. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë,

VENDIM

Për Aprovimin e Planit të punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2020 / Lënda: 01Nr. 60/01-2249/20.

10. Raporti i punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Ky është një raport tre mujor i këtij Komiteti Konsultativ, nga koha kur është bërë anëtarësimi i tyre. Për tre muaj që kanë punuar ky komitet është për t'u përshëndetur për aktivitetin që ka zhvilluar. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

znj. Arlinda Rakoci-Raka, Unë kisha kërkuar një bashkëpunim më të madh të prindërve të personave me aftësi të kufizuara me Drejtorinë e Arsimit dhe me Komitetin Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara, në mënyrë që familjarët me i paraqitur personat me aftësi të kufizuara, sepse kemi raste kur ngurrojnë më i paraqitur këto kategori të personave.

z. Besim Vishi, Unë po ndërlihem të pika 5- Kërkesat, ku thuhet së ky komitet e ka adresuar një Kërkesë në DUKMM lidhur me punimet që janë bërë në rrugën “ Idriz Seferi” dhe përreth xhamisë, që këto punime të bëhen sipas standardeve të kërkuara për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, mirëpo këtu thuhet se, qasje nuk ka ndryshuar dhe përgjigje nuk kanë marrë ky komitet në kërkesën e adresuar.

z. Ramadush Osmani, Disa objekte përreth kanë qasje edhe për persona me aftësi të kufizuara, ndërkaq ato të cilat nuk kanë, do t'i bëjmë në bazë të një kontratë.

z. Selim Reka, Nga Raporti, po shihet se ky komitet ka bërë një punë të mirë, ndërkaq ne si shoqëri kemi bërë pak që me iu krijuar qasje në të gjitha objektet ndërtimore këtyre personave. Këtë e themi, sepse ka shumë objekte shkollore dhe objekte tjera që nuk kanë qasje për PAK.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë Raport pune e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë,

VENDIM

Raporti i punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2019; respektivisht, Periudhën : Janar-Shtator 2019 / Lënda: 01Nr. 60/01-2076/20.

12. Informatë e DAK për përfundimin e Periudhës së Parë të Vitit shkollor 2019-2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Informata për aktivitetin e shkollave në periudhën e parë të vitit shkollor 2019/2020 është e hartuar mirë, është paraqitur në formë të drejtë gjendja e shkollave të komunës. Shqetësuese për ne janë, numri i mungesave të nxënësve dhe i arsimtarëve në të gjitha shkollat, pavarësisht së ka edhe mungesa me arsye për shkaqe të ditura. Tjetër, shqetësuese është zvogëlimi i numrit të nxënësve nga viti në vit për shkak të migrimit të familjeve jashtë vendit apo regjistrimit të nxënësve në komunat tjera për shkak të afërsisë apo të drejtimeve. Nëse vazhdohet ky trend, atëherë paralelet në shkollat tona dita ditës shihet së po shkojnë drejt shuarjes. Rëndësi të veçantë në vitin 2020 duhet me iu kushtuar çështjes së arsimit në; rregullimin e ambientit në disa shkolla, pajisjen e shkollave me kabineteve, teknologji informative etj.. Kur jemi të pajisja e shkolave me kabine, shkolla e mesme “Skënderbeu” në Kaçanik, është një klasë e lirë, e cila klasë mundet me u përdorur për kabine.

z. Adnan Reka, Për kundër së Informata është hartuar mirë dhe më statistikave të mjaftueshme, gjendja në sistemin arsimor komunal nuk është e mirë. Punësimet në DKA-ndonëse formalisht janë të rregullta, praktikisht shihet se është drejtorja e cila më së shumti duhet të rehatojë të gjitha motrat, bashkëshortet dhe të afërmit e shërbëtorëve politik të pushtetit të cilët qëllim të vetëm kanë punësimin sa më të madh të familjarëve të tyre në sektorin publik.

Infrastruktura shkollore, është e vërtetë se bëhen investime të konsiderueshme në objekte shkollore, por pyetja është, si shpërndahen këto investime, cilat janë kriteret, mos janë kriteret politike apo ato të nepotizmit, sepse gjendja e shkollave në komunën tonë le shumë për të dëshiruar. Tani, nuk është e lehtë t’ju themi fëmijëve tanë se ne prindërit e juaj kemi mësuar në të njëjtën shkollë në kushte më të mira se ju para 50 viteve. Unë do të doja të dija sa objekte shkollore kemi të braktisura dhe sa janë në prag të braktisjes në komunë, dhe kur janë ndërtuar këto objekte, para apo pas lufte. (Llanishtë, Koxhaj, Sllatinë)

Të ngritja e cilësisë në arsim, formalisht ne mund të flasim për ngritje të cilësisë në arsim, por realisht duhet të pajtohem se derisa kemi punësime politike, atëherë kemi edhe trajnime politike dhe të nepotizmit për ngritjen e kapaciteteve në arsim, e si rrjedhojë edhe rezultatet e nxënësve janë në rënie, për 2,86%, apo nga 166 nxënës, vetëm 26 nxënës (apo 15, 66%) e kalojnë testin e arritshme-risë, këto janë fakte shqetësuese.

z. Besim Vishi, Është e vërtetë së shqetësuese është numri i madh i mungesave të nxënësve dhe arsimtarëve, ndërkaq ka shumë nxënës që ka tre nota të dobëta, kjo është shqetësuese. Të çështja e renovimeve në shkolla fillore, a ka mundësi me u bërë, Plani për eficientë –me solarë, si në shkollën fillore në f. Ivajë dhe në shkolla të tjera ku ka rinovime, në mënyrë që me shpenzuar me pak energji elektrike në këto shkolla.

z. Bekim Koxha, Të çështja e arsimit, shqetësuese është çështja e punësimeve, sepse nuk mundet me u punësuar askush, pa pasur një lidhje të ngushtë me Kryetarin e Komunës apo me stafin tjetër të ekzekutivit të komunës. Një rast punësimi është, Kryetari i Komunës e ka punësuar në sektorin e pylltarisë dhëndrin e tij, pa konkurs dhe pa pasur kualifikim.

z. Selim Reka, Të ndarja e vitit shkollor në tre perioda, kjo mënyrë po del të jetë jo e suksesshme. Nëse iu epet rasti, është mirë kjo çështje me u debatuar në nivel qendror, për më ndryshuar kjo ndarje e vitit shkollor, në mënyrë që rezultatet të jenë më të mëdha.

z. Shemsedin Luzha, Unë e kam një vërejtje për një punëtor teknik të shkollën fillore të f. Begracë, për çështjet të cilat ngritën këtu, kërkoj që mos të dalin jashtë për t'u komentuar më të tjerët së kush çka ka ngritur e diskutuar.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Nëse keni argumente për pranimet sipas konkurseve të shpallura është mirë me na i ofruar. Të shqetësimi të cilin e ngrit z. Bekim Koxha të çështja e pranimet të shoferit tim, kur është pranuar ky punëtor, atëherë procedura ka qenë përmes konkursit publik dhe tani që ka ndryshuar procedura e pranimet të stafit të Kryetarit të Komunës, ju a mendoni së duhet me larguar nga puna atë person apo kushdo qoftë tjetër që është pranuar me procedurë të konkursit.

z. Bekim Koxha, Për mendimin tim me dërguar dike me punuar në Sektorin e pylltarisë që nuk është i kualifikuar për atë lëmi, kujtoj së nuk është në rregull, sepse kjo po na kushton në të ardhmen.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Zyrtari që është transferuar në sektorin e Pylltarisë, është zyrtar i thjeshtë, e jo zyrtar profesional. Ne si komunë kemi pasur të drejtë më bërë transfer të punëtorit më pagë të njëjtë dhe kjo është bërë dhe nuk shoh asgjë të keqe në këtë rast.

z. Zahir Doda, Së pari iu përshëndes të gjithëve dhe iu falënderoj për vlerësimin tuaj në informatë për të dhëna të sakta të cilat janë paraqitur në material. Është e vërtetë për numrin e madh të mungesave të nxënësve dhe të arsimtarëve, mirëpo një arsimtar nëse mungon unë nuk kam të drejtë me bërë zëvendësim pa procedura, ndërkaq procedura e zëvendësimit i merr së paku 1 muaj e gjysmë, kështu që çështja e procedurave po na kushton me mungesa të rritjen e numrit të mungesave. Këtu është në pyetje ligji, sepse nuk na lejon më bërë zëvendësime në bazë të listës pritëse.

Të pyetja e Adnan Reka, të punësimet e mësimdhënësve, unë e falënderoj Kryetarin e Komunës që ka mbështetur çdo rekomandim të komisionit, kjo është për t'u vlerësuar, sepse ai që i ka plotësuar kushtet e konkursit, pavarësisht partisë apo diç tjetër është pranuar në punë. Me tregoni ndonjë rast ku është shkelur kjo rregull, atëherë unë do të merrem me rastin konkret. Kur një kandidat i plotëson kushtet e konkursit, unë kujtoj se cilido kandidat qoftë nëse është edhe fëmija im, unë jam më marrë në punë.

z. Adnan Reka, Më intereson të di, a ka punësime në sektorin e Arsimit mbi numrin që është e lejuar me norma ligjore për komunën tonë ? A ka të punësuar me kontratë në vepër dhe a ka praktikantë në shkolla ? Pyetje tjetër: A dirigjohet komisioni i rekrutimit nga ndonjë kush ?

z. Zahir Doda, Në drejtori nuk ka të punësuar tepër, ndërkaq mësimdhënës ka më tepër sesa është e lejuar. Në vazhdim drejtori i DAK i dha arsyet e numrit të punësuarve mbi normë, për shka të pushimeve, zëvendësimeve e të ngjashme.

z. Adnan Reka, Unë kam informata së ka shkollë e cila nuk e ka numrin 500 nxënës që nuk kanë të drejtë me pasur punëtor administrativ, ndërkaq ka shkolla me numër të nxënësve nën këtë numër, ndërkaq kanë punëtorë administrativ. Sa i përket zëvendësimeve, zëvendësimet mundën me u bërë nga kuadri brenda shkollës.

z. Zahir Doda, Ata punëtorë të cilët i ka dërguar ministria me bërë praktikën në shkolla, unë absolut nuk kanë të bëjë asgjë DAK apo Komunën. Komuna nuk është e ngarkuar me buxhetin e saj për kompensimet e atyre punëtorëve. Barrë më iu bërë pagesat atyre punëtorëve është ministria e cila i ka dërguar me kryer praktikën në shkolla.

z. Shemsedin Luzha, Me gjithë respektin për drejtorin e DAK, Zahir Doda, mirëpo vërejtjet tona janë më vend. Nëse duam me ecur përpara si shoqëri në të gjitha proceset edhe ato në arsim, duhet punojmë e veprojmë sipas rregullave ligjore.

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë konstatoj së Kuvendi i Komunës u,

Njoftua

Me aktivitetin e sektorit të Arsimit, për përfundimin e Periudhës së Parë të Vitit shkollor 2019-2020 në bazë të dhënave të paraqitur në Informatë e hartuar nga DAK / Lënda: 01Nr. 610/01-2019/20.

12. Informatë për aktivitetin e Kuvendit të Komunës për vitin 2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Theksoj së në këtë dokument është paraqitur aktiviteti i Kuvendit të Komunës për vitin 2019. Informata është hartuar nga zyrtarja e Kuvendit, Makfire Malsiu, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Të çështja e dërgimit të materialit të mbledhjes 7 ditë para mbledhjes, ka pasur raste kur materiali i mbledhjes për ndonjë pikë nuk është ofruar në afatin e përcaktuar ligjor, dhe për këto arsye në subjekti politik i LVV e kemi lëshuar mbledhjen për pikët të cilat nuk na është dërguar me kohë materiali për pikët e caktuara. Të KPF, unë mendoj se duhet reflektuar në përbërje Grupi i pavarur i përfaqësuar në KK.

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës u,

Njoftua

Me aktivitetin e pasqyruar të KK përmes materialit, Informatë për aktivitetin e Kuvendit të Komunës për vitin 2019 / Lënda: 01Nr. 60/01-2122/20.

z. Ekrem Raka, Kam një pyetje, A duhet të shtrohet në votim Plani i Punës së Ekzekutivit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, Ligji nuk e përcakton se duhet të votohet Plani i punës së ekzekutivit të komunës, ndërkaq nëse duhet të votohet ky plan pune, atëherë shtrohet pyetja, çka nëse nuk e merr miratimin? Mos miratimi i tij nuk ka pasoja juridike. Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu që konstatoj mbledhjen të përfunduar, ora: 12:30. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 26 anëtarë, anëtarë, Sali Malsiu ishte prezent në pjesën e parë të mbledhjes, pasi që me leje të Kryesuesi i Kuvendit doli më herët nga mbledhja.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Makfire Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërse



REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 2017);

**nga Mbledhja e I-r (Parë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin
2020 mbajtur me 31 Janar 2020**

1. Kemal Mërseli.....,
2. Hamid Guri.....,
3. Ahmet Luma,
4. Kadri Krivenjeva,.....,
5. Besim Vishi,.....,
6. Sali Malsiu.....,
7. Lirije Shurdhani.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,
9. Lirije Luta.....,
10. Vlora Dalloshi.....,
11. Nexhat Loku,
12. Agim Mani.....,
13. Adnan Reka.....,
14. Ekrem Kyçyku.....,
15. Fatijona Kyçyku.....,
16. Kaltrina Tafili,
17. Selim Reka.....,
18. Besnik Salihu,.....,
19. Nazife Krasniqi.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,
21. Shemsedin Luzha.....,
22. Albana Troni.....,
23. Afërdita Shehi,.....,
24. Hajredin Luta.....,
25. Hafize Sallahi,
26. Bekim Koxha.....,
27. Ekrem Raka,.....,



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 25.02.2020

Për: Anëtarët e Kuvendit/ z. Adnan Reka
z. Shemsedin Luzha

Lënda: PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe të jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruar para Kuvendit të Komunës, më datë 31.01.2020, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.

z. Adnan Reka, Kërkojmë nga DSHPE, të bëjë sanimin e gropës së mbushur me ujë që përfshinë më tepër se gjysmën e rrugës, në segmentin e rrugës Bob – Kovaçec, me saktë përballë shkollës së mesme profesionale.

- Drejtoria e shërbimeve Publike ka të kontraktuar kompaninë për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale. Sapo të krijohen kushtet e volitshme për sanimin e gropave me shtresë asfalti ne do të intervenojmë në të gjitha rrugët ku kemi të evidentuara dëmtime dhe prerje të shtresës së asfaltit.*

z. Shemsedin Luzha,

- Rruga në f. Begracë në lagjen Luzha, ka nevojë edhe për një shtresë asfalti, sepse kjo rrugë është dëmtuar shumë shpejt nga koha kur është ndërtuar;
- Ura në Kaçanik të Vjetër nuk është ndërtuar mirë, ndërkaq dihet sesa është e frekuentuar ajo pjesë,
- Shprehi shqetësimet e mia për, mungesën e ndriçimit publik në fshatin Doganaj, pjesa për gjatë lokaleve;
- Kam vërejtje që qytetarët e komunës, i prenë rrugët e asfaltuara për nevoja të tyre pa marrë ndonjë leje nga komuna.


- Prioritet i ekzekutivit të komunës në aspektin e infrastrukturës rrugore është ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve të cilat nuk kanë fare shtresë asfalti, kurse në vitet e ardhshme do të shqyrtohen mundësitë buxhetore për shtrimin e shtresës së dytë të asfaltit në rrugët që tashmë janë të asfaltuara.*
- Ura mbi lumin Nerodime në fshatin Kaçanik i Vjetër është duke u implementuar bazuar në projektin e detajizuar nga kompania projektuese, kurse rreth cilësisë së ndërtimit të saj, ajo mbikëqyret nga menaxheri i kontratës dhe më pas bëhet pranimi teknik i saj nga komisioni përkatës.*
- Në kuadër të investimeve kapitale për vitin 2020, është projektit “Rregullimi i ndriçimit publik”. Janë të ndara mjete buxhetore në shumë 45,000.00€. Drejtoria e Shërbimeve*

Publike do të shqyrtoj mundësitë për investime në rrjete të reja të ndriçimit publik në rrugët me prioritet të komunës.

- *Bazuar në Rregulloren për Shërbime Publike, DSHPE-ja jep pëlqim për prerjen e shtresës së asfaltit në rruget lokale bazuar në kërkesën e palëve. Për një pëlqim pala paguan tarifën e caktuar nga organi komunal kurse sanimin me shtresë të re e bëjmë përmes kompanisë së kontraktuar për mirëmbajtjen e rrugëve lokale. Nëse haset në prerje pa pëlqim të organit kompetent kërkohet të vepron inspektorati i komunës.*

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,


Ramadush Osmani
Drejtor i DSHPE-s





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Data	28.01.20	Vendi	KAÇANIK
Ij. org.	06	Numri	610/01-6262
		Shtojcë	1

DREJTORIA E ARSIMIT DHE KULTURËS

Përgjigje në pyetjen e z. Shemsedin Luzha,

Më intereson të di, a është marrë ndonjë veprim lidhur me kërkesën të cilën e kam ngritur për një vend pune në arsim që paguhen dy arsimtarë;

Përgjigje: Për të njejtën pyetje keni qenë të informuar se për vendin e punës të mësimdhënësit Sefedin Luzha është shpallur konkurs publik dhe tash kanë përfunduar procedurat e rekrutimit dhe është zgjedhur mësimdhënësja Jetmire Shehu.

DAK
Drejtori, Z. Doda





Datë: 28.02.2020

Për: Anëtarin e kuvendit të Komunës, Z. Shemsedin Luzha;

Nga: Drejtori i Administratës së Përgjithshme, Z. Festim Neziraj;

Lënda: Sqarim

I nderuar z. Luzha,

Duke iu referuar shqetësimeve tuaja që i keni shprehur në mbledhjen e Kuvendit të kaluar lidhur me mos-funksionimin e zyrës së Gjendjes Civile në Kačanik të Vjetër, të rekomandoj të lexosh Raportin e Ekzekutivit për vitin 2019. Në faqen 02 dhe 03 të raportit, gjeni shpjegim të hollësishëm për çështjen në fjalë.

Me respekt,